



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2022:213208

Datë: 05.08.2024

Numri i dokumentit: 06039986

### NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ - Departamenti i Përgjithshëm, divizioni penal,** me gjyqtarin e vetëm gjykues Dardan Maloku, me zyrtaren ligjore Ardita Tasholli, në çështjen penale ndaj të pandehurit L.A., me vendbanim në fshatin ... - Komuna Ferizaj, për shkak të veprës penale Kanosja nga neni 181 paragrafi 3 lidhur me paragrafin 2 të Kodit 06/L-074 Penal të Republikës së Kosovës (tani e tutje KPRK-së), sipas Aktakuzës të paraqitur nga Prokuroria Themelore në Ferizaj – Departamenti i Përgjithshëm, PP/II.nr.1540/22, të datës 04.11.2022, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor, të hapur për publikun, më datë 27.06.2024, në të cilën kanë marrë pjesë të gjitha palët dhe atë prokurori i shtetit Egzon Jakupi, prokuror në Prokurorinë Themelore në Ferizaj, i pandehuri L.A. me mbrojtësin e tij me autorizim av. Arben Isufi dhe i dëmtuari F.S., më datë 01.07.2024, mori dhe publikisht shpalli, kurse më datë 05.08.2024, përpiloi këtë:

### A K T G J Y K I M

#### Të akuzuarit:

L.A., nga i ati M. dhe e ëma H., e gjinisë A., i lindur më ..., në fshatin ... – Komuna Ferizaj, me vendbanim në të njëjtin vend, me numër personal ..., ka të kryer shkollën fillore, me profesion bujk, i martuar, prindër i tre fëmijëve, i gjendjes së varfër ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

### Ë S H T Ë F A J T O R

#### Sepse:

Me datë 12.05.2022, në rrugën e “...” në Ferizaj, saktësisht brenda Stacionit Policor në Ferizaj, i pandehuri përderisa kishte qenë prezentë gjatë marrjes në pyetje për një rast të djalit të tij H.A., seriozisht e kanos me fjalë të dëmtuarin zyrtarin policor F.S., se do ta privoj nga jeta, në

atë mënyrë që fillimisht ju drejtohet me fjalë “me ty do të shihemi, kemi me kry më vonë”, dhe pastaj i thotë dëshmitarit G.Q.se “unë e kam një kallash te shpija edhe e di se qysh i drejtoj punët me F.n”, me të cilin veprim tek i dëmtuari ka shkaktuar frikë dhe pasiguri.

- Me këtë ka kryer verën penale **Kanosja** nga 181 paragrafi 3 lidhur me paragrafin 2 të KPRK-së.

Andaj gjykata në bazë të neneve 4, 7, 8, 17, 21, 38, 42, 44, 69, 70, 181 paragrafi 3 lidhur me paragrafin 2 të KPRK-së, si dhe neneve 364, 452, 455 paragrafi 1 dhe 459 paragrafi 4 të Kodit të Procedurës Penale (KPP-së), të pandehurin e :

## G J Y K O N

- I. Dënim me burgim në kohëzgjatje prej njëqind e tetëdhjetë (180) ditë, i cili me pëlqimin e të pandehurit i zëvendësohet me dënim me gjobë në shumën prej tetëqind (800) euro, të cilën shumë i pandehuri është i obliguar ta paguaj brenda afatit prej nëntëdhjetë (90) ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.
- II. Nëse i pandehuri nuk mundet apo nuk dëshiron ta paguajë dënimin me gjobë, të njëjtit në pajtim me nenin 43 paragrafi 3 të KPRK-së, dënimi me gjobë do ti zëvendësohet me dënim me burgim, ashtu që për njëzetë (20) € gjobë të papaguara, i pandehuri do të vuajë një (1) ditë burgim.
- III. I dëmtuari F.S. nga fshati ... – Komuna Ferizaj, nuk ka paraqitur kërkesë pasurore juridike.
- IV. Obligohet i pandehuri në emër të shpenzimeve të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej njëzet (20) € si dhe për fondin e kompensimit të viktimave të dhunës shumën prej njëzet (20) €, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

## A R S Y E T I M

## **1. Rrjedha e çështjes dhe fjala përfundimtare**

Prokuroria Themelore në Ferizaj – Departamenti i Përgjithshëm ka ngritur aktakuzën PP/II.nr.1540/22, të datës 04.11.2022, ndaj të akuzuarit L.A., me vendbanim në fshatin Komogllavë – Komuna Ferizaj, për shkak të veprës penale Kanosja nga neni 181 paragrafi 3 lidhur me paragrafin 2 të KPRK-së.

Më datë 02.02.2023, është mbajtur seanca e shqyrtimit fillestar.

Më datë 14.12.2023, 29.01.2024, 13.05.2024, 25.06.2024 dhe 27.06.2024 janë mbajtur seancat e shqyrtimit gjyqësor ku kanë prezantuar të gjitha palët dhe atë prokurori i shtetit në Prokurorinë Themelore në Ferizaj, i pandehuri L.A. me mbrojtësin e tij me autorizim av. Arben Isufi dhe i dëmtuari F.S..

Prokurori i shtetit në fjalën e tij përfundimtare ka deklaruar se: nga provat që janë administruar gjatë shqyrtimit gjyqësor është vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë gjendja faktike si në aktakuzë, po ashtu edhe fajësia e të pandehurit për kryerjen e verës penale “kanosja”, fakt ky i cili është vërtetuar edhe me dëshminë e dëshmitarit – të dëmtuarit F.S. dhe dëshmitarit G.Q., si dhe me provat materiale të propozuara në aktakuzë të cilat janë administruar gjatë shqyrtimit gjyqësor. Tutje prokurori i shtetit në fjalë përfundimtare ka përshkruar tërë rrjedhën e situatës, me të cilën ka theksuar se janë vërtetuar të gjitha dëshmitë e dëshmitarit F.S. të dhëna gjatë fazës së hetimeve për të cilën i pandehuri L.A. ka kanosur me fjalët “*me ty do të shihemi më vonë, kemi me krye më vonë*”, gjithashtu ka përshkruar edhe dëshminë e dëshmitarit G.Q. të paraqitur në fazën e hetimeve, për të cilën është përshkruar rrjedha e situatës duke treguar se si i pandehuri L.A. me të arritur në Stacionin Policor kishte qenë i nervozuar – i shqetësuar me sjelljet e djalit të tij, duke i bërë titur dhe tentuar ta sulmoj fizikisht, me ç` rast kishin konsideruar lloj kërcënimi dhe menjëherë kishin reaguuar duke i thënë që të qetësohet, aty prezent kishte qenë edhe F. tërë kohët, për të cilën i pandehuri i`u ishte drejtuar F.t me fjalë se “*kemi me u pa, i drejtojmë senet jashtë policisë*”, në të cilën F. i është përgjigjur se “*në çfarë mënyre do të zgjidhet problemi*” dhe “*ke kujdes çka fol se mund të iniciojë ndonjë rast*”, pasi që është larguar F., në prezencën e dëshmitarit kishte thënë se “*unë e kam një kallash në shtëpi dhe e dijë qysh i zgjidhi unë problemet me të*”. Të njëjtit për këto fjalë kishin njoftuar shefin e ndërrimit dhe kishin përpiluar raport dhe me urdhër të Prokurorit të Shtetit është hapur rast.

Prokurori, thekson se i pandehuri ka kryer veprën penale si në dispozitiv të aktakuzës, kjo vërtetohet edhe në provat materiale, të cilat janë administruar edhe në shqyrtimin gjyqësorë. Tutje, shtoi se i pandehuri në shqyrtimin gjyqësor ka mohuar kryerjen e veprës penale, duke deklaruar se nuk është e vërtetë që ka kanosur zyrtarin policor, por vetëm se ka qenë në Stacionin Policor në Ferizaj, i pandehuri ka kërkuar nga G. që të sqaroj se kush i a kishte rrahur djalin tij dhe në ato momente kishte hyrë F. dhe e kishte qitur dorën e djathtë në derë dhe ka thënë “ *unë ta kam rrahur djalin po njërës mos dërgo se unë ju njoh juve*”, për të cilën i njëjti ka kërkuar numrat identifikues të policisë por të njëjtat nuk ia kanë dhënë, dhe i kishte thënë “ unë ty F. të njohë dhe do të ndjekë me ligj deri ku është ma së nalti”, me ç ‘rast në ato momente kishin dal nga zyra F. dhe G.. Tutje ka theksuar se është e vërtetë që ka qenë i frustruar me djalin e tij kur kishte shkuar dhe nuk është fjalosur me zyrtarët policor, ndërsa në zyrë ka qenë vetëm me G.n, pasi që në zyrë është marr në pyetje djali i tij, F. nuk ka hyrë. Prokurori i shtetit vlerëson se mbrojtja e të pandehurit nuk mbështet në provat personale dhe materiale dhe ky mohim është bërë vetëm sa për t`iu shmangur përgjegjësisë penale, gjithashtu konsideron se është vërtetuar dyshimi i bazuar mirë se i pandehuri ka kryer veprën penale kanosja nga neni 181 paragrafi 3 lidhur me paragrafin 2 të KPRK-së. Andaj, lidhur me këtë gjykatës i ka propozuar që të pandehurin ta gjejë dhe të shpallë fajtorë për veprën penale e cila i vihet në barë duke marr për bazë rrethanat që ndikojnë në matjen e dënimit dhe përcaktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit, duke shtuar gjykata duhet të merre për bazë ashpërsimin e dënimit, të ketë parasysh shkallën e lartë të dashjes për kryerjen e veprës penale, intensitetin e rrezikimit apo dëmtimit të vlerës së mbrojtur, sjelljen e mëparshme me të cilin i njëjti më parë ka kryer vepra të tilla dhe të ngjashme penale, si dhe gjykata të shqiptoj një dënim ashtu siç parashihet në kualifikimin ligjor të veprës penale dhe të ketë parasysh me atë dënim të arrihet qëllimi i dënimit.

Mbrojtësi i të pandehurit L.A. – Av Arben Isufi në fjalën e tij përfundimtare të dorëzuar me shkrim ka theksuar se: I mbrojturi i tij L.A. është akuzuar nga prokuroria për veprën penale kanosja nga neni 181 paragrafi 3 lidhur me paragrafin 2 të KPRK-së, duke mos u mbështetur në prova bindëse të cilat do të mjaftonin për të dëshmuar një vepër penale. Tutje ka shtuar se deklarata e palës së dëmtuar – zyrtarit policor F.S. se gjoja i pandehuri ka kanosur se do ta privoj nga jeta, nuk është e vërtetë dhe si të tillë gjykata nuk duhet ta marrë për bazë për të dënuar L.A., ngase e njëjta nuk mund të provohet dhe aq më pak e bënë të besueshëm fakti se kanosja ka ndodhur brenda stacionit policor. Mbrojtësi theksoi se krejt ky skenar është përgatitur nga F.S. në bashkëpunim dhe me dëshmitarin e propozuar nga prokuroria G.Q., me

qëllim për ta mbrojtur veten, pasi që L.A. iu ka thënë se do ti denoncoj dhe se të kërkoj të drejtën deri në fund, ngase të njëjtit ishin sjellë në mënyrë ç` njerëzore me djalin e tij të mitur, duke e rrahur e shkaktuar lëndime trupore. Mbroja konsideron se rasti është inskenuar nga zyrtarët policor F.S. dhe G.Q., ngase në deklaratën e G. Q. në cilësinë e dëshmitarit e dhënë në prokurori thuhet se *“Unë e F. nuk kemi qenë pjesë e arrestimit të djalit të të pandehurit”*, ndërsa F.S. deklaroi se *“Unë dhe G. kemi shkuar dhe e kemi marrë të dyshuarin H.A. dhe e kemi sjellë në Stacionin Policor në Ferizaj”*. Ndërkaq, në momenti kur i pandehuri ka kërkuar të dij se kush ia ka rrahur djalin, ka hyrë F. duke thënë në mënyrë të krekosur se *“unë ta kam rrahur djalin dhe mos gabo me më dërgua njerëz..”* ndërsa L.A. i drejtohet me fjalët *“se do përgjigjesh para organeve për veprimet që ke bërë”*. Mbrojtësi thekson se F.S. në dëshminë e tij të datës 13.05.2024 në pyetjet e gjyqtarit u njëjti deklaroi se *“nuk besoj që ka diçka personale dhe se ditën kritike L.A., frustrimet e djalit të tij i ka shfaqur te unë”*, nga kjo av. Arben Isufi, konsideron se çdo deklaratë e të dëmtuarit, gjykata duhet ta trajtoj si përpjekje për ti mbuluar veprimet e tij të kundërligjshme ndaj H.A.. Gjithashtu, edhe në deklaratimet e G.Q. të dhëna në shqyrtimin gjyqësor më datë 13.05.2024, janë konfuze, ngase deklaroi se *“brenda 15 minutave e kemi dërguar në spital, ia kemi thirre prindin dhe e ka marrë tretmanin mjekësor dhe pastaj e kanë sjellë në Stacionin Policor”*, intervali kohor për 15 minuta nuk qëndron, ngase në deklaratat e H.A. të dhëna në pyetjet e prokurorit të shtetit janë se *“fillimisht më kanë dërguar tek mjeku dhe gjysmë orë pasi që jemi kthyer nga mjeku ka ardhur babai”*, Nga kjo deklaratë kuptohet se palët i dëmtuar dhe dëshmitari pasi e kanë sjellë nga spitali H. ia kanë thirrur prindin, duke shkelur procedurat ligjore që fillimit është dashur të ia thërrasin prindin dhe prindi të jetë edhe në spital gjatë marrjes së tretmanit. Gjithashtu, mbrojtësi në fjalë përfundimtare shtoi se sa i përket deklaratës së dëshmitarit G. se i pandehuri L. iu ka drejtuar me fjalët se *“unë kam kallash në shtëpi dhe di se si ti zgjidh punët me F.n”* një deklaratë të tillë personi H.A. i cili ka qenë prezent e ka demantuar, i cili në pyetje e mbrojtësit të tij se a ka dëgjuar kërcënim, është deklaruar se *“jo, nuk ka përdor fjalë kërcënuese”* si dhe në pyetjen, se a ka dëgjuar L.A.n duke ju drejtuar zyrtarit policor G.Q.me fjalë *“unë e kam një kallash te shpija dhe e dij qysh i zgjidhi unë problemet me të”* H. ka deklaruar se *“jo nuk e kam dëgjuar”*. Andaj, tutje mbrojtësi konsideron se një deklaratë e tillë mbrojtësi thotë se nuk ka ndodhur dhe se shihet se është planifikuar së bashku me F.t në mënyrë që t`i mbulojnë veprimet e kundërligjshme në rastin e trajtimit të H.A.t, djalit i të pandehurit L.A.. Tutje mbrojtësi ka theksuar se Prokurori gjatë shqyrtimit gjyqësor nuk ka ofruar asnjë provë me të cilën do të dëshmonte se i mbrojturi i tij e ka kryer veprën penale të cilën e ngarkon aktakuza, duke

kërkuar nga gjykata se në mungesë të provave dhe në përputhje me nenin 363 paragrafi 1.3 të KPPRK-së të merr aktgjykim lirues me të cilin të pandehurin e liron nga aktakuza.

I pandehuri në fjalën tij përfundimtare ka deklaruar se: e mbështes fjalën përfundimtare të mbrojtësit të tij, kërkoi nga gjykata drejtësi me rastin e tij, e ndjen veten të pafajshëm, i njëjti jeton me gruan e tij dhe me dy djemtë e tij. Tutje shtoi se jep pëlqimin që në rast se gjykata vendos të shqiptoj dënim me burgim, të më zëvendësoj me dënim me gjobë, mirëpo duke shtuar se ndihet i pafajshëm.

## **2.Provat e administruara**

Në shqyrtim gjyqësor gjykata ka administruar provat si në vijim:

- Dëshmia e të dëmtuarit – dëshmitarit F.S.;
- Dëshmia e dëshmitarit G.Q.;
- Dëshmia e dëshmitarit H.A.;

Si dhe provat materiale:

- Procesverbali për kontroll dhe sekuestrim të përkohshëm me numër të rastit 2022-CF-856 i datës 12.05.2022,
- Raporti i oficerit i datës 12.05.2022, i përpiluar nga zyrtari Policor A.H.;
- Raporti i oficerit i datës 12.05.2022, i përpiluar nga zyrtari Policor F.S.;
- Raporti i oficerit i datës 12.05.2022 i përpiluar nga zyrtari policor G.Q.;
- 6 (gjashtë) fotografi si dhe provat tjera që gjenden në shkresat e lëndës.

### **2.1. Deklarata e të dëmtuarit – dëshmitarit F.S.**

I dëmtuari - dëshmitari F.S. në seancën e shqyrtimit gjyqësor të datës 13.05.2024, ka deklaruar se: Punon që nga viti 2005 në Policinë e Kosovës, i njëjti, fillimisht ka punuar në SP-Prishtinë, në vitin 2022 punoi në SP-Ferizaj në Njësinë Reaguese ndërrimi C, duke shtuar se nuk i kujtohet se ka dhënë deklaratë para prokurorit të shteti lidhur me këtë rast për shkak të kohës së gjatë, me ç' rast nga Prokurori i shtetit i prezantohet deklarata e tij e dhënë në Prokurori më datë 28.10.2022, dhe i njëjti e konfirmon se nënshkrimi i të gjitha faqet e kësaj deklarate është i tij dhe për këtë rast i kujtohet mirë se djali i të pandehurit L.A. – H.A. ka qenë i mitur në atë kohë në bazë të dispozitave ligjore e ka ndalur për arsye se ka kryer kundërvajtje në trafik dhe pastaj përmes telefonit zyrtar e ka njoftuar prindin e tij, tani të pandehurin L.A. se e ka djalin në stacion policor dhe se do ti marrin deklaratë për arsye se ka ikur nga patrullat e policisë. Pas

rreth pesë – dhjetë minutave, i njëjti ka shkuar ne stacion policor, e kanë pritur tek hyrja dhe e kanë drejtuar tek dhoma ku ishte duke qëndruar djali i tij dhe i njëjti ka qenë i frustruar me djalin e tij sepse i ka ikur patrullës dhe pastaj ka filluar me agresivitet ndaj djalit të tij duke i bërtitur dhe ka ndërhyre dhe i ka thënë “*ti nuk ke të drejtë me i bërtit apo me përdor ndonjë lloj force ndaj djalit të tij, pavarësisht veprimeve që i ka bere*”, i njëjti nuk ka marr ndonjë veprim fizik ndaj tij, mirëpo i ka thënë se “*me ty do te shihemi më vonë*” dhe këto fjalë ia ka thënë me ton normal dhe i dëmtuari F.S. kishte thënë se “*çka kemi mu pa ma vonë*”, i pandehuri i kishte thënë se “*e sheh se çka kemi mu pa më vonë*”, ndërsa nga këto fjalë i dëmtuari ishte ndjerë i kanosur dhe të njëjtit ia ka tërhequr vërejtjet dhe i ka thënë “*mos vazhdo me këto lloj shprehje për arsye se do te hapim rast penal*” dhe pastaj ishte larguar nga dhoma dhe policët tjerë kanë vazhduar me intervistimin, pastaj rreth një ore e kishte thirrur në telefon shefi i ndërrimit R.H. dhe i ka thënë se ta shkruaj një raport për arsye se personi kishte vazhduar me kanosje ndaj meje se “*e kam një kallash te shpija për policin F.S.*” dhe këto fjalë ja ka thënë kolegut të tij G.Q.dhe i njëjti e kishte përpiluar raportin. Gjithashtu, tutje ka shtuar se është ndier i frikësuar për dy arsye, sepse pas verifikimit në sistemin e policisë ndaj të pandehurit ka figuruar shumë vepra penale si i dyshuar, gjithashtu i njëjti në stacionin policor i ka pasur me vete edhe disa persona të cilët vlerësoj se kanë qenë familjarë të tij, mirëpo pas këtij rasti të pandehurin nuk e ka takuar asnjëherë dhe as që nuk ka dëgjuar asgjë rreth këtij personi. I dëmtuari F.S. tutje në deklaratën e tij ka theksuar se nuk ka kërkuar ndonjë trajtim mjekësor për veten lidhur me shqetësimet që i ka pasur dhe shtoj se edhe sot ndjehet i frikësuar nga i pandehuri, mirëpo duke e pasur parasysh përgjegjësinë profesionale nuk i takon që ta shfaq këtë frikë. Duke shtuar se i pandehuri nuk besoj që ka diçka personale me atë, sepse nuk e ka njohur me herët, mirëpo për shkak të frustrimit të veprimeve të djalit te tij, ai pastaj e ka shfaqur edhe tek ata.

## **2.2. Deklarata e dëshmitarit G.Q.**

Dëshmitari G.Q.në seancën e shqyrtimit gjyqësor të datës 13.05.2024, ka deklaruar se: më datë 12.05.2022, ka qenë i arrestuar H.A., djali i tani të pandehurit dhe arsyeja e arrestimit të tij ishte mos ndalja në pikë kontrollin në fshatin ... dhe më pas edhe shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm, i njëjti ishte duke e drejtuar automjetin e markës “*Äudi*” për të cilën kishin arritur ta ndalnin vetëm pasi kishin kaluar 6 km. Pas ndaljes H.n e kishin dërguar së bashku me F. në stacion policor dhe se në stacion policor ka ardhur prindi i tij L.A., i cili është njoftuar menjëherë nga F. përmes telefonit me numër zyrtar dhe i njëjti ka ardhur shumë shpejt rreth 10-15 minuta dhe të njëjtin e kanë njoftuar për arsyen e ndaljes së djalit të tij. Tani i pandehuri

– babai i H.A.t, L.A. ishte nervoz- i shqetësuar me sjellët e djalit të tij dhe ndaj djalit të tij e ka pasur një reagim impulsiv duke i bërtitur në dhomën ku ishte i ndalur dhe ka tentuar fizikisht që e kemi konsideruar si lloj kërcënimi dhe kanë reaguar dhe i kishin thënë që të qetësohet, aty ka qenë prezent F. gjatë tërë kohës, i njëjti fillimisht nuk ju është drejtuar F.t me ndonjë fjalë, por më vonë i kishte thënë se “*kemi me u pa, i drejtojnë senet jashtë policisë*”, ndërsa F. i ka thënë se ke kujdes çka fol sepse mund të iniciohet ndonjë rast. Tutje dëshmitari deklaroi se pas këtyre fjalëve, F. e pyet të pandehurin se “*në çfarë mënyre do të zgjidhet problemi*” mirëpo në ato momente nuk ka qenë prezent F.S.. Nga kjo deklaracion se i pandehuri ka thënë se “e kam një kallash te shtëpia dhe e di se qysh i zgjidhi unë problemet me atë”, ndërkaq, pas kësaj i njëjti e kishte njoftuar shefin e ndërrimit R.H. për fjalët të cilat ai i ka thënë dhe pas njoftimit që ia kishte dhënë shefit, kishte njoftuar F.n dhe pasi kishin bërë raportin me urdhër të prokurorit është hapur rasti, duke shtuar se para këtij rasti se kishte parë asnjëherë të pandehurin në Stacion Policor. Dëshmitari tutje deklaracion se gjatë arrestimit H. nuk kishte ndonjë shenjë të dhunës, përpos se ishte i pluhosur si pasoj e arrestimit, arsyeja pse e kanë dërguar së bashku me F.n në spital për tretman mjekësor, pasi e kishin njoftuar prindin e tij, ka qenë kërkesë e H.t, ngase i njëjti është ankuar se kishte dhimbje shpine, koke dhe ishte i shqetësuar. Nga dërgimi në spital dhe kthimi në stacion policor kanë qenë kohë 15 minuta gjithashtu brenda 5 minutave e kanë dërguar në spital dhe e kanë thirrur prindin e tij. Në dëshminë e tij theksoi se deklaracionin e H.t e ka marrë në praninë e prindit të tij, gjithashtu shtoi se deklaracionin e dhënë të njëjtit e kishin nënshkruar. Shton se F. është kërcënuar nga i pandehuri si pasoj e kontaktit të parë që kishte si zyrtarë policor lidhur me rastin, në dhomën e intervistimit së bashku me të kishte qenë prezent edhe F.S., por ky i fundit ishte ndal tek dera ngase i njëjti ishte njoftuar për arsyen e ndaljes së djalit të pandehurit. Nuk i kujtohet se i pandehuri ka pyetur se kush ia ka rrah djalin, gjithashtu shtoi se nuk i kujtohet se i pandehuri e ka pyetur djalin e tij H.n se pse është dërguar në spital si dhe nuk ka informacion se nëse H.n e kanë marrë në pyetje ndonjë zyrtar tjetër policor. Gjithashtu shtoi se të pandehurin para këtij rasti nuk e ka njohur, i pandehuri emrin e të dëmtuarit e ka kuptuar gjatë qëndrimit në Stacion Policor pasi që i dëmtuari F.S. fillimisht iu ishte prezantuar.

### **2.3. Deklarata e dëshmitarit H.A.**

Dëshmitari H.A. në seancën e shqyrtimit gjyqësor të datës 25.06.2024, ka deklaruar se: F.S.n e njeh që është zyrtar policor nga një rast që ka pasur, i kujtohet se më datë 12.05.2021 apo 2022 është arrestuar nga policia dhe se ka qenë në Stacionin Policor në Ferizaj, ku aty F.S. ka



ushtruar dhunë ndaj tij, gjithashtu, thekson se si pasoj e lëndimeve të cilat i ka marrë ka kërkuar ndihmë mjekësore për të cilën ndihmë e ka marrë. Gjatë arrestimit nga zyrtari policor F.S. nuk iu kanë lexuar të drejtat e tij, gjatë deklaratës së tij të dhënë në Polici pran zyrtarit policor F.S., prezent kanë qenë edhe zyrtari policor G.Q.dhe babai i ti L.A., tutje thekson se në ditën kritike gjatë dhënies së deklaratës babai i tij – i pandehuri L.A., nuk ka përdor fjalë kërcënuese zyrtarin policor F.S., ndërsa thekson se i ka thënë G.Q.që le ti shënoj në procesverbal që e kanë rrahur dhe e kanë shty me e la gjakun në banjë dhe aty babai i tij i ka kërkuar numrat e policëve, nuk ka dëgjuar e babai i tij iu ka drejtuar G.Q.me fjalët “*unë e kam një kallash tek shtëpia dhe e di se qysh i zgjidhi un problemet me të*”. Gjithashtu, deklaroi se gjatë marrjes në pyetje avokat nuk ka pasur, duke shtuar se gjatë marrjes në pyetje G.Q.ka dal jashtë, ndërsa babai e ka pyetur se “*kush të ka rreh*”, në ato momente ka hyrë në derë F.S. dhe ka thënë “*unë e kam rrah por njërëz mos më qo te shpija*”, ndërsa babai iu ka thënë se “*tani ka me të ndjek unë me ligj*”. Dëshmitari në pyetjet e prokurorit të shtetit në shqyrtimin gjyqësor ka deklaruar se është arrestuar për shkak se nuk iu është bindur urdhrave të policisë për t`u ndaluar, babai i tij kishte shkuar në polici gjysmë orë pasi janë kthyer nga mjeku, i njëjti gjatë dhënies së deklaratës së tij, para zyrtarëve policor, ka qenë prezent gjatë tërë kohës, gjithashtu deklaroi se shkaktimin e dhunës fizike nga ana e zyrtarëve policor e ka raportuar pas një kohe.

### **3. Mbrojtja e të akuzuarit**

I akuzuari L.A. në seancën e shqyrtimit gjyqësor nuk e ka pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën është akuzuar, duke theksuar se F. e ka thirrur më datë 12.05.2022, duke i thënë se “*djalin H.n e ka në Stacion Policor*”, pas 30 minuta i njëjti kishte shkuar në Stacion Policor në Ferizaj dhe e kishte kërkuar policin F.S., ndërsa aty kishte qenë tek hyrja e stacionit G.Q., i njëjti ishte prezantua dhe e kishte ftuar që të hyj brenda në stacion dhe në katin e parë në anën e majtë prej hyrjes zyra e parë ishte djali i tij H. i ulur, duke shtuar se djali ishte i stresuar dhe e kishte pyetur se “*çka ke ba*” ai e kishte ulur kokën dhe ishte dridhur, mendova se kishte ftoftë dhe i kishte dhënë tërnerkën e tij. Pastaj, G. kishte shkuar me një letër në dorë dhe ka thënë se duhet me ja marr një deklaratë H.t në prezencën tij dhe gjatë marrjes së deklaratës kur ka arritur deklarata gati gjysmë faqe, kur ka filluar të flas H. për çështjen e mjekut dhe ka theksuar se e kanë dërguar në banjo me pastru gjakun, ndërsa G. nuk ka dashur ta shënoj këtë pjesë në procesverbal, dhe në atë moment e kishte pyetur G.n se a bënë me ditë se kush ma ka rrahur djalin? Në atë moment kishte hyrë F.n duke e qitur dorën e djathë në derë dhe kishte thënë “*unë ta kam rrahur djalin, po njerëz mos me dërgo se unë ju njohë juve*”. Ndërkaq i njëjti kishte

kërkuar numrat identifikues të policisë, të cilat numra nuk ia kishin dhënë dhe i pandehuri i kishte thënë se “unë ty F. të njoh dhe do të ndjekë me ligj deri ku është më së nalti” dhe kam dal nga ajo zyre F. dhe G. dhe më nuk ishte takuar me ata. I njëjti tutje ka deklaruar se ndërkohë kishte ardhur edhe një polic tjetër emrin e të cilit nuk e din, ku i njëjti i kishte thënë “ti i kërcënon njerëzit edhe me kallash se të njohim ty”, ndërsa më vonë kishte shkuar polici R.M.dhe i kishin dërguar në katin e tretë të pandehurin L. dhe djalin e tij H.n, aty kanë dhënë deklarata ku aty ka qenë edhe avokati, pastaj kanë zbritur poshtë dhe djalin e kanë liruar, ndërsa të pandehurit i kanë thënë hajde brenda pak e kanë mbajtur në ndalim deri në ora 10 të ditës, gjithashtu deklaroi se të nesërmen policia kanë bastisur shtëpinë për të cilën asgjë nuk kanë gjetur, nga kjo të njëjtit gjykata i kishte caktuar masën e arrestit shtëpiak për një (1) muaj. Ditën kritike nuk ishte i frustruar me djalin e tij H.n e as nuk e kishte tonin e lartë, gjithashtu mohon se i njëjti e kishte kërcënuar të dëmtuarin F.. Kur kishte shkuar në stacionin policor kishte qenë vetëm, kur e kishte parë djalin se kishte një shenjë në fytyrë dhe maica e tij ishte me gjak i kishte thënë se “ është dashur të ndalesh policisë”. Duke shtuar se pas këtij rasti kishte takuar rastësisht në qytet babin e F.t, fillimisht nuk e kam ditur se i njëjti ishte babai i F.t dhe duke biseduar ai kishte thënë se “sa i përket ligjit ndiqe deri në fund e marre i qoftë djalit tim se çka paska bërë këtij fëmije”. Deklarohet se ndaj policit F.S. nuk ka përdorur fjalë të cilat po thonë dhe as policit G.Q.nuk i kishte thënë se “*unë e kam një kallash te shtëpia dhe e di se qysh i drejtoj punët me F.n*”, duke shtuar se këtë rast ndaj tij e kishin iniciuar vetëm për arsye se kishte insistuar me shkrua në deklaratë se “*djalin e kam shtrirë për toke me duar lidh dhe e kanë rrahur*” për arsye se i pandehuri i kishte njoftuar se do t`i lajmëroj në Prishtinë. Në mbrojtjen e tij shtoi se nuk është e vërtet se ka thënë fjalë kërcënuese, duke theksuar se edhe më herët kishte raste në polici dhe i dinte rregullat dhe konsideronte se kishte vepruar në bazë të rregullave.

#### **4. Vlerësimi dhe analizimi i provave**

Në seancat e shqyrtimit gjyqësor në këtë çështje penale gjykata bazuar në nenet 7 dhe 360 të KPP-së, saktësisht dhe në mënyrë të plotë vërtetoi faktet që janë të rëndësishme për marrjen e vendimit të ligjshëm, me vëmendje dhe përkushtim maksimal dhe me përkujdesje të njëjtë vërtetoi faktet kundër të akuzuarit si dhe ato në favor të tij duke i mundësuar të njëjtit shfrytëzimin e të gjitha fakteve dhe provave që janë në favor të mbrojtjes dhe me ndërgjegje vlerësoi çdo provë një nga një dhe në lidhje me provat tjera, gjithashtu edhe në bazë të

vlerësimit të tillë ka nxjerr përfundimin lidhur me faktet konkrete të vërtetuara me ç ‘rast pas analizimit dhe vlerësimit të provave të cilat janë administruar në seancën e shqyrtimit gjyqësor ka ardhur në përfundim se në këtë çështje penalo - juridike është vërtetuar përtej dyshimit të bazuar mirë se i akuzuari e ka kryer veprën penale Kanosja nga neni 181 paragrafi 3 lidhur me paragrafin 2 të KPRK-së.

Gjykata vlerëson si të pakontestueshme rrethanën se i pandehuri në ditën kritike ka qenë në stacionin policor lidhur me rastin e djalit të tij.

Gjykata ia fali besimin e plotë dëshmisë së të dëmtuarit – dëshmitarit F.S. pasi që dëshmia e tij përputhet me provat personale dhe materiale të administruara nga gjykata. Nga dëshmia e të dëmtuarit - dëshmitarit gjykata gjeti se i akuzuari L.A. në ditën kritike ka qenë në Stacionin Policor në Ferizaj dhe se i njëjti është telefonuar nga vet i dëmtuari me qëllim që i njëjti të jetë prezent gjatë dëshmisë së djalit të tij H.t, i cili ishte ndaluar nga policia pasi që i njëjti nuk iu është bindur urdhrave të policisë për ndalim. Pas rreth pesë – dhjetë minutave, i njëjti ka shkuar ne stacion policor, e kanë pritur tek hyrja dhe e kanë drejtuar tek dhoma ku ishte duke qëndruar djali i tij dhe i njëjti ka qenë i frustruar me djalin e tij sepse i ka ikur patrullës dhe pastaj ka filluar me agresivitet ndaj djalit të tij duke i bërtitur dhe ka ndërhyre dhe i ka thënë “*ti nuk ke të drejtë me i bërtit apo me përdor ndonjë lloj force ndaj djalit të tij, pavarësisht veprimeve që i ka bere*”, i njëjti nuk ka marr ndonjë veprim fizik ndaj tij, mirëpo i ka thënë se “*me ty do te shihemi më vonë*” dhe këto fjalë ia ka thënë me ton normal dhe i dëmtuari F.S. kishte thënë se “*çka kemi mu pa ma vonë*”, i pandehuri i kishte thënë se “*e sheh se çka kemi mu pa më vonë*”, ndërsa nga këto fjalë i dëmtuari ishte ndjerë i kanosur dhe të njëjtit ia ka tërhequr vërejtjet dhe i ka thënë “*mos vazhdo me këto lloj shprehje për arsye se do te hapim rast penal*” dhe pastaj ishte larguar nga dhoma dhe policët tjerë kanë vazhduar me intervistimin. I pandehuri kishte vazhduar me kanosje ndaj tij se “*e kam një kallash te shpija për policin F.S.*” dhe këto fjalë ja ka thënë kolegut të tij G.Q..

Gjykata ia fali besimin e plotë dëshmisë së dëshmitarit G.Q. pasi që dëshmia e tij përputhet me provat personale dhe materiale të administruara nga gjykata. Nga dëshmia e tij gjykata gjeti se i akuzuari L.A. kishte qenë në stacion policor pasi është njoftuar menjëherë nga zyrtari policor F.S. për rastin e djalit të tij. Tani i pandehuri – babai i H.A.t, L.A. ishte nervoz- i shqetësuar me sjellët e djalit të tij dhe ndaj djalit të tij e ka pasur një reagim impulsiv duke i bërtitur në dhomën ku ishte i ndalur. I pandehuri i ka thënë se “*e kam një kallash te shtëpia dhe e di se qysh i zgjidhi unë problemet me atë (F.S.n)*”, ndërkaq, pas kësaj i njëjti e kishte njoftuar shefin

e ndërrimit R.H. për fjalët të cilat ai i ka thënë dhe pas njoftimit që ia kishte dhënë shefit, kishte njoftuar F.n dhe pasi kishin bërë raportin me urdhër të prokurorit është hapur rasti, duke shtuar se para këtij rasti se kishte parë asnjëherë të pandehurin në Stacion Policor.

Gjykata ia fali pjesërisht besimin dëshmisë së dëshmitarit H.A. dhe nga e njëjta gjeti se i njëjti është arrestuar nga policia dhe se ka qenë në Stacionin Policor në Ferizaj, pastaj në stacionin policor në Ferizaj ka arritur edhe babai i tij tani i pandehuri L.A., ndërsa nuk ia fali besimin në pjesën e deklaratës ku ka theksuar se babai i tij – i pandehuri L.A., nuk ka përdorur fjalë kërcënuese zyrtarin policor F.S. dhe se nuk e ka dëgjuar babain e tij iu ka drejtuar G.Q.me fjalët *“unë e kam një kallash tek shtëpia dhe e di se qysh i zgjidhi un problemet me të”*.

Gjykata ia fali pjesërisht besimin mbrojtjes së të pandehurit dhe nga e njëjta gjeti se i njëjti ka qenë në stacionin policor dhe aty i ka takuar zyrtarët policor F.S. dhe G. Q. si dhe djalin e tij H.A. i cili e kishte cilësinë e të dyshuarit, mirëpo gjykata nuk ia fali besimin pjesës së deklaratës ku ka theksuar se ndaj policit F.S. nuk ka përdorur fjalë kërcënuese dhe as policit G.Q.nuk i kishte thënë se *“unë e kam një kallash te shtëpia dhe e di se qysh i drejtoj punët me F.n”*, ngase i njëjti në vazhdimësi është thirrur duke aluduar se i dëmtuari F.S. së bashku me dëshmitarin G.Q.ishte një skenar i tyre me qëllim që të njëjtit të i mbulojnë veprimet e tyre të cilat konsideron se janë veprime të kundërligjshme. Mirëpo, një pretendim të tillë nuk e ka mbështetur me prova konkrete.

Nga Procesverbali për kontroll dhe sekuestrim të përkohshëm me numër të rastit 2022-CF-856 i datës 12.05.2022, gjykata gjeti se është zbatuar urdhër kontrolli në shtëpinë e të pandehurit por nuk është gjetur asgjë.

Nga Raporti i oficerit i datës 12.05.2022, i përpiluar nga zyrtari Policor F.S. gjykata gjeti se i pandehuri L.A. e kishte kanosur të njëjtin me fjalët *“ me ty shihemi kemi me kry”* dhe *“e sheh ma vonë”* si dhe kolegut të tij G.Q.i pandehuri i kishte thënë se *“për F.n e kam një kallash te shpija dhe merrem ma vonë me të”*. Ky fakt është vërtetuar edhe nga Nga Raporti i oficerit i datës 12.05.2022, i përpiluar nga zyrtari Policor A.H..

Nga Raporti i oficerit i datës 12.05.2022 i përpiluar nga zyrtari policor G.Q., gjykata gjeti se i pandehuri L.A. i ishte drejtuar zyrtarit policor G.Q.me fjalët *“unë e kam një kallash dhe e di qysh i drejtoj punët me F.n”*.

Nga 6 (gjashtë) fotografi gjykata gjeti se H.A., djali i të pandehurit L.A. ka pasur gërvishtje në fytyrë dhe në disa pjesë të trupit mirëpo këto fotografi nuk përmbajnë shënime lidhur me kohën se kur janë bërë si dhe në fotografi paraqitet edhe një recetë për barna me numër ...1 e datës 19.01.2023 në emër të H.A.t ku të njëjtit i janë përshkruar barnat: Amoxicillin 500mg, Prospan dhe Galasel pro.

### **5.Gjendja faktike e vërtetuar**

Duke u bazuar në të lartcekurat, gjykata vërtetoi këtë gjendje faktike: se i pandehuri L.A. me datë 12.05.2022, në rrugën e “...” në Ferizaj, saktësisht brenda Stacionit Policor në Ferizaj, i pandehuri përderisa kishte qenë prezentë gjatë marrjes në pyetje për një rast të djalit të tij H.A., seriozisht e kanos me fjalë të dëmtuarin zyrtarin policor F.S., se do ta privoj nga jeta, në atë mënyrë që fillimisht ju drejtohet me fjalë “me ty do të shihemi, kemi me kry më vonë”, dhe pastaj i thotë dëshmitarit G.Q.se “unë e kam një kallash te shpija edhe e di se qysh i drejtoj punët me F.n”, me të cilin veprim tek i dëmtuari ka shkaktuar frikë dhe pasiguri.

Neni 181 paragrafi 2 i KPRK-së përcakton se: “*Kushdo që seriozisht i kanoset personit tjetër me fjalë, vepra apo gjeste se do ta privojë nga jeta ose se do t’i shkaktojë lëndim të rëndë trupor, se do ta rrëmbejë ose privojë nga liria ndonjë person tjetër ose se do ta dëmtojë me armë zjarri, me shpërthim ose me mjete të tjera të rrezikshme, dënohet me gjobë ose me burgim deri në një (1) vit*”, si dhe paragrafi 3 i po të njëjtit nen përcakton se: “*Kur vepra penale nga paragrafi 1. ose 2. i këtij neni kryhet ndaj personit zyrtar në lidhje me punën apo me pozitën e tij ose ndaj disa personave ose kur vepra kryhet nga kryesi i cili vepron si anëtar i grupit, kryesi dënohet me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vjet*”. Për ekzistimin e kanosjes duhet që personit të cilit i drejtohet, t’i bëhet e qartë se çfarë e keqe do godas si dhe që ai person do t’i shkaktojë të keqen. Në sensin e këtij inkriminimi, kanosja duhet të jetë serioze, gjegjësisht të jetë objektivisht e tillë që tek i kanosuri të krijohet bindja se do të realizohet, se vërtetë do ta godas ajo e keqe e cila i bëhet me dije. Kanosja duhet të jetë e drejtpërdrejtë e cila do të pasojë menjëherë apo së shpejti. Pasoja e kësaj vepre është shkaktimi i frikës, ankthit apo pasigurisë tek i kanosuni. Vepra do të ekzistojë nëse objektivisht ka shkaktuar ndjenjën e frikës dhe ankthit. Kjo vepër fillon me vet shprehjen e kanosjes, ndërsa kryhet kur kanosja objektivisht ka shkaktuar frikë apo ankth tek i kanosuni. Në sensin e dispozitës së nenit 181, për t’u konsideruar kanosja si vepër penale ajo duhet që të jetë: a) serioze, b) e mundshme, dhe c) e tanishme. Kanosja është serioze në rastet kur ekziston mundësia reale se e keqja e cila

bëhet me dije do të shkaktohet. Kanosja është e mundshme nëse e keqja që është bërë me dije është realisht e mundshme, që vërtetë mund të realizohet nga personi i cili është kanosë. Kanosja konsiderohet e tanishme (aktuale) nëse e keqja mund të realizohet menjëherë, tani apo në një të ardhme të afërt. Andaj, në rastin konkret duke pasur parasysh se i pandehuri L.A. i është drejtuar të dëmtuarit F.S. me fjalët: “*me ty do të shihemi, kemi me kry më vonë*”, dhe pastaj i thotë dëshmitarit G.Q.se “*unë e kam një kallash te shpija edhe e di se qysh i drejtoj punët me F.n*”, si dhe duke pasur parasysh faktin se tek i dëmtuari këto fjalë kanë shkaktuar frikë dhe kërcënim.

Se kanosja ka qenë serioze e mundshme dhe e tanishme mbështetet edhe në faktin se i akuzuari është shpallur fajtor dhe është dënuar me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë PKR. 1026/2006 i plotfuqishëm me datë 24.06.2008 për veprën penale Mbajtja në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 328 i Kodit të Përkohshëm Penal por edhe pas kryerjes së kësaj vepre penale i njëjti është shpallur fajtor dhe i dënuar me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Ferizaj PKR.nr. 2022:015616 i plotfuqishëm me datë 03.04.2024 për shkak të veprës penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 i KPRK-së, si dhe i njëjti është recidivist – përsëritës i shumëfishtë i veprave penale për të cilat më gjerësisht do të arsyetohet tek pjesa e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit. Andaj, pritshmëria dhe frika e të dëmtuarit se do ti shkaktohet ndonjë e keqe kanë qenë reale, serioze, e mundshme dhe e tanishme. Kurse kualifikimi nga paragrafi 2 i nenit 181 është përmbushur pasi që fjalët “*unë e kam një kallash te shpija edhe e di se qysh i drejtoj punët me F.n*” kanë kuptimin e kanosjes për privim nga jeta. Vepra penale është kualifikuar në Kanosja nga neni 181 paragrafi 3 lidhur me paragrafin 3 të KPRK-së, duke pasur parasysh se vepra penale është kryer ndaj zyrtarit policor e që neni 113 paragrafi 2 i KPRK-së ka përcaktuar cilësinë e personit zyrtar për zyrtarët policor.

Andaj nga të gjitha të lartcekurat gjykata vërtetoi përtej dyshimit të bazuar mirë se i akuzuari L.A., ka kryer veprën penale Kanosja nga neni 181 paragrafi 3 lidhur me paragrafin 2 të KPRK-së, në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

## **6. Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit**

Gjykata me rastin e matjes së dënimit ka vlerësuar që të akuzuarit ti shqiptohet dënim me gjobë në shumën prej 800 (tetëqind) euro, të cilin dënim i pandehuri është i obliguar ta paguajë brenda afatit prej 90 (nëntëdhjetë) ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, ngase duke i marrë parasysh të gjitha rrethanat dhe provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës, ky dënim do

të jetë i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe përgjegjësinë penale të kryesit dhe si i tillë me këtë dënim mund të arrihet qëllimi i dënimit në kuptim të nenit 38 të KPRK-së. Gjithashtu gjykata me rastin e matjes së dënimit ka marrë për bazë edhe rrethanat që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit duke u bazuar në nenet 69 dhe 70 të KPRK-së, ashtu që rrethanë lehtësuese për të pandehurin ka marrë faktin se i njëjti është mbajtës i familjes, kurse rrethana rënduese gjeti shkallën e lartë të dashjes nga ana e të pandehurit për kryerjen e veprës penale, vendin e kryerjes së veprës penale ku vepra penale është kryer brenda stacionit policor si dhe faktin se i njëjti është recidivist i veprave penale dhe atë i shpallur fajtor dhe i dënuar me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë PKR. 1026/2006 i plotfuqishëm me datë 24.06.2008, i shpallur fajtor dhe i dënuar me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Ferizaj P.nr. 1296/2012 i plotfuqishëm me datë 29.03.2013, i shpallur fajtor dhe i dënuar me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Ferizaj P.nr. 2019/2012 i plotfuqishëm me datë 06.06.2013, i shpallur fajtor dhe i dënuar me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Ferizaj P.nr. 400/2014 i plotfuqishëm me datë 30.06.2014, i shpallur fajtor dhe i dënuar me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Ferizaj P.nr. 125/2011 i plotfuqishëm me datë 18.09.2014, i shpallur fajtor dhe i dënuar me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Ferizaj P.nr. 840/2013 i plotfuqishëm me datë 19.03.2015, i shpallur fajtor dhe i dënuar me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Ferizaj P.nr. 131/2017 i plotfuqishëm me datë 30.03.2017, i shpallur fajtor dhe i dënuar me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Ferizaj P.nr. 354/2016 i plotfuqishëm me datë 27.03.2018, i shpallur fajtor dhe i dënuar me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Ferizaj P.nr. 476/2017 i plotfuqishëm me datë 02.10.2019, i shpallur fajtor dhe i dënuar me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Ferizaj P.nr. 272/2018 i plotfuqishëm me datë 19.11.2019, i shpallur fajtor dhe i dënuar me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Ferizaj P.nr. 272/2019 i plotfuqishëm me datë 18.12.2019 dhe i shpallur fajtor dhe i dënuar me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Ferizaj PKR.nr. 2022:015616 i plotfuqishëm me datë 03.04.2024.

Andaj, duke u bazuar në të lartcekurat gjykata konsideron se me dënimin e shqiptuar ndaj të akuzuarit mund të arrihen qëllimet e dënimit të parapara në nenin 38 të KPRK-së e që konsistojnë në parandalimin e kryesit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij, të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale, të bëjë kompensimin e viktimave ose të komunitetit për humbjet ose dëmet e shkaktuara nga vepra penale dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

## **7. Vendimi lidhur më kërkesën pasurore juridike**

Neni 459 paragrafi 4 i KPP-së përcakton se: “Kur personi i autorizuar nuk e ka paraqitur propozimin për realizimin e kërkesës pasurore juridike në procedurë penale para ngritjes së aktakuzës, ai duhet njoftuar se propozimin mund ta paraqesë deri në përfundim të shqyrtimit gjyqësor. Kur me vepër penale është shkaktuar dëm në pasurinë në pronësi publike, shtetërore ose shoqërore dhe nuk është paraqitur propozim, gjykata për këtë e njofton organin ose personin kompetent sipas nenit 458, paragrafi 2 i këtij Kodi. Pala informohet se mosparaqitja e propozimit mund ta përjashtojë palën e dëmtuar nga Programi i Kompensimit të Viktimave edhe nëse pala do të plotësonte kriteret tjera të pranueshmërisë sipas ligjit në fuqi”. Andaj, gjykata e ka njoftuar palën e dëmtuar për këtë të drejtë, mirëpo i njëjti ka deklaruar se nuk paraqet kërkesë pasurore juridike.

## **8. Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale**

Duke pasur parasysh natyrën e kësaj çështje penale, gjykata duke u bazuar në nenin 452 paragrafi 1 të KPP-së, ka vendosur që ta detyrojë të pandehurin që të paguaj paushallin gjyqësor në shumën prej 20 (njëzet) euro, si dhe duke u bazuar në nenin 36 paragrafi 3 nën paragrafi 3.1 të ligjit Nr. 08/L-109, për Kompensimin e Viktimave të Krimin shumën prej 20 (njëzet) Euro.

Andaj duke u bazuar në të lartcekura gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

### **GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ**

**Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal**

**2022:229365, me datë 05.08.2024**

**Zyrtarja ligjor,**

Ardita Tasholli

**Gjyqtari i vetëm gjyqës,**

Dardan Maloku

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi mund të paraqitet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej 30 (tridhjetë) ditëve nga dita e pranimit të të njëjtit. Ankesa në kopje të mjaftueshme i paraqitet Gjykatës Themelore në Ferizaj.